

Pasqyra faktografike e statusit të implementimit të masave të paraparë në Planin 3-6-9 përfundimisht me 15.11.2017

Hyrja

Plani 3-6-9 u miratua më 04.07.2017, ndërsa ditën e ardhshme u prezantua para opinionit. I njëjti u përgatit si përgjigje e rekomandimeve nga takimet e shumta me partnerët tanë ndërkombëtarë, para se gjithash me BE-në, në drejtim të zhbllokimit të proceseve eurointegruese të Republikës së Maqedonisë. Të gjithë këto takime ishin orientuar pikërisht drejt përgatitjes, harmonizimit dhe ndërmarrjes së obligimeve që janë inkuorporuar në këtë Plan.

Drejtimi i reformave, del nga Programi për punën e Qeverisë 2017-2020, Marrëveshja politike e Përzahinos dhe i ndjek rekomandimet nga takimet e nivelit të lartë me përfaqësuesit e institucioneve të BE-së, përfshirë edhe Prioritetet urgjente të reformës, si dhe rekomandimet e Këshillit të Evropës, përkatësisht Komisionit të Venedikut dhe GREKO, OSBE/ODIHR-së dhe raportet e grupit të ekspertëve të udhëhequr nga Pribe, si dhe konsultimet me sektorin civil.

Masat e propozuara afatshkurtër, të përmbajtur në këtë Plan, duhet të realizohen deri në Zgjedhjet lokale. Masat tjera që përpunohen nga ana e institucioneve kompetente, duhet të realizohen deri në nëntor/dhjetor ose para mbajtjes së Këshillit të BE-së në dhjetor, si dhe ato që do të duhet të realizohen deri në muajin mars vitin e ardhshëm, ose deri në publikimin e raportit të ardhshëm të rregullt të Komisionit Evropian për Maqedoninë.

Në definimin e masave në këtë Plan morën pjesë dhe kontribut të tyre dhanë shërbimet profesionale të të gjithë institucioneve kompetente, Kuvendit, Qeverisë, institucioneve shtetërore, sektorit civil dhe opozitës. U vendos edhe mekanizëm për koordinim, monitorim dhe ndjekje të implementimit në nivel ministror dhe operativ. Do të përpilohen raporte adekuate dhe do të dorëzohen në Kuvendin, Komisionin Evropian dhe te partnerët ndërkombëtarë, si dhe te sektori civil dhe opinionit i gjerë.

Në vazhdimësi është dhënë Pasqyrë faktografike e statusit të implementimit të masave të parapara në Planin 3-6-9 përfundimisht me 15.11.2017, në bazë të informatave të marrë nga burimi zyrtar. Struktura e kësaj pasqyre e ndjek strukturën e Planit 3-6-9.

1. Zgjedhjet

Në pjesën e zgjedhjeve, Qeveria i pranon rekomandimet e OSBE/ODIHR-së dhe Komisionit të Venedikut dhe të njëjtat i implementon në afat të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë. Në afat të shkurtër masat fokusohen në mbështetjen e Komisionit Shtetëror dhe në konsolidimin e brendshëm dhe përforcimin e kapaciteteve të tyre, e në kontekst të përgatitjes së zgjedhjeve lokale, përfshirë edhe azhurnimin e Listës së zgjedhësve, edukimin e administratës zgjedhore dhe votuesve.

Statusi i realizimit të masave:

- Në mbledhjen e Qeverisë të mbajtur më 05.09.2017 u miratua “Angazhimi deklarativ për zgjedhje të lira dhe të drejta”, me të cilin potencohet rëndësia e zgjedhjeve të lira, të drejtpërdrejta dhe demokratike si dhe vlera themelore e Rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë, si dhe respektimi i të drejtës së pacenueshme të zgjedhësve dhe realizimi i papenguar i procesit zgjedhor pa ndikime dhe presion politik mbi votuesit.
- Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike në pajtim me obligimet nga Kodi Zgjedhor, nga 7.8.2017 filloi të realizojë monitorim të rregullt javor të njoftimit mediatik pas shpalljes së zgjedhjeve. Në raportet u monitorua respektimi i standardeve dhe principeve profesionale për kryerje të veprimtarisë dhe ndalim të njoftimit për aktivitetet e pushtetit në funksion të prezantimit mediatik zgjedhor.
- ASHAAM përpiloi Raport nga monitorimi i njoftimit mediatik zgjedhor për Zgjedhjet lokale 2017, në të cilin

konkludoi se shumë televizione dhe radio u përmbahen standardeve profesionale, e disa duke marrë pozitë kritike ndaj pushtetit. Megjithatë, te disa servise programore kishte shmangie me ç'rast janë ngritur procedura adekuate për kundërvajtje.

- Angazhimi i punës i personave të punësuar në seksionin juridik, dhe sektorët për listë zgjedhore dhe IT në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve është siguruar deri në fund të vitit, si të punësuar të përkohshëm që pritet të transformohen në punësime të përhershme gjatë vitit të ardhshëm. Akti për sistematizim, akti për organizim të brendshëm dhe raporti nga analiza funksionale u miratuan, e më 30.08.2017, u mor pëlqimi nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës për aktin e sistematizimit.
- Në mbledhjen e Qeverisë të mbajtur më 12.09.2017, u miratua "Udhëzim për mënyrën e veprimit të ministrive, organeve tjera të administratës shtetërore dhe organizatave administrative gjatë procesit zgjedhor" me të cilin përcaktohen drejtimit për mënyrën e veprimit të ministrive, organeve tjera të administratës shtetërore dhe organizatave tjera, funksionarëve që udhëheqin me organet shtetërore si dhe të punësuarve në organet shtetërore gjatë realizimit të zgjedhjeve parlamentare, presidenciale dhe lokale nga dita e shpalljes së tyre e deri në përfundimin e tyre në pajtim me ligjin. Në pajtim me këtë udhëzim, gjatë procesit zgjedhor nuk mund të fillojë ndërtimi i objekteve të reja në infrastrukturë ose objekteve për veprimtari shoqërore me mjete nga buxheti, dhe nuk mund të mbahen evenimente publike me rastin e ndërtimit ose lëshimit të objekteve të tilla në përdorim. Pastaj, nuk mund të paguhen rroga, pensione dhe kompensime tjera nga buxheti, të cilat nuk janë pagesa të rregullta mujore, nuk mund të tjetërsohet kapitali shtetëror, as të nënshkruhen marrëveshje kolektive. Gjithashtu, Ministria e Financave, doemos duhet publikisht (në internet) t'i publikojë të gjitha shpenzimet buxhetore në periudhën zgjedhore. Gjithashtu, në organet shtetërore nuk mund të fillojë procedura për punësim të personave të rinj, ose procedura për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Më tutje, funksionarët e zgjedhur nuk mund të shfrytëzojnë informata të marrë gjatë kryerjes së funksionit në fushatën zgjedhore, si dhe nuk guxojnë të ushtrojnë presion mbi të punësuarit për të marrë pjesë në aktivitete zgjedhore, as të përdorin kërcënime ose frikësime ndaj të punësuarve në lidhje me punësimin e tyre, sigurimin social. Ndërsa, të punësuarit në organet shtetërore nuk mund të marrin pjesë në aktivitete zgjedhore gjatë orarit të punës, as të kryejnë aktivitete partiake ose të paraqesin simbole partiake në vendin e punës.
- Në mbledhjen e Qeverisë të mbajtur më 12.09.2017, u miratua "Udhëzimi për ndalimin për shfrytëzimin e sendeve të tundshme dhe të patundshme në pronësi shtetërore gjatë procesit zgjedhor", me çka përcaktohen drejtimit për mënyrën e veprimit të ministrive, organeve tjera të administratës shtetërore dhe organizatave administrative, në lidhje me shfrytëzimin e sendeve të tundshme dhe të patundshme në pronësi shtetërore gjatë realizimit të zgjedhjeve parlamentare, presidenciale dhe lokale nga dita e shpalljes së tyre e deri në përfundimin e tyre në pajtim me ligjin. Në pajtim me këtë udhëzim në organet shtetërore (zyra, hapësira), si dhe në hapësirat e punës që gjenden në objekte të organeve shtetërore, nuk mund të mbahen takime ose të kryhen aktivitete në lidhje me procesin zgjedhor. Gjithashtu, sendet e tundshme të cilat i shfrytëzojnë organet shtetërore nuk mund të shfrytëzohen për nevojat e fushatës zgjedhore.
- Më 5.7.2017 u miratua Rregullore e re për punën e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve.
 - Për vendosjen e strukturës së re organizative të Shërbimit profesional të KSHZ-së, u miratuan aktet vijuese: Raporti nga analiza e realizuar funksionale, raporti nga analiza e realizuar për nevojën për njësi rajonale dhe zyra, akti i ri për sistematizim të vendeve të punës.
 - Në prag të zgjedhjeve, KSHZ-ja i miratoi aktet nënligjore në vijim: Rregullore të re për mënyrën dhe procedurën për zgjidhje të kundërshtimeve (5.7.2017 dhe ndryshime dhe plotësime më 21.07.2017), udhëzim për mënyrën dhe procedurën për parashtrim, pranim dhe vërtetim të listave të kandidatëve për Zgjedhje lokale (21.07.2017), udhëzim për vërtetimin e identitetit të votuesit (21.07.2017), udhëzim për listat e vlefshme dhe të pavlefshme të votuesve (21.07.2017), program për edukimin e KKZH dhe KZH (16.08.2017), doracakë për edukimin e KKZH dhe KZH dhe është incizuar video doracak.

- Në pajtim me nenin 31 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 2 të Rregullores për punën e KSHZ-së, mbledhjet e Komisionit janë publike. Në mbledhjet e punës me përfaqësuesit e KSHZ-së u theksua nevoja për të siguruar transparencë të plotë të punës së mbledhjeve të KSHZ-së në pajtim me Kodin Zgjedhor.
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë, në mbledhjen e 25-të, të mbajtur më 29.08.2017, miratoi Vendim me të cilin Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, iu nda hapësirë për shfrytëzim të përhershëm pa kompensim, me çka u tejkalua problemi me të cilin ballafaqohej Komisioni.
- - Bëhet azhurnimi i vazhdueshëm administrativ i Listës së zgjedhësve, si dhe kontrollimi i integritetit të dokumenteve për identifikim personal të cilat i lëshon MPB-ja.
 - Ka filluar implementimi i Marrëveshjes për këmbim të të dhënave me DMLA në kuadër të projektit për interoperabilitet. U realizua suksesshëm testimi provues i këmbimit kompjuterik të të dhënave.
 - Lista e zgjedhësve është vazhdimisht në dispozicion në faqen e KSHZ-së me të dhënat vijuese: emri, mbiemri dhe adresa e zgjedhësve. Azhurnimi i saj bëhet në bashkëpunimin me MPB-në dhe ESHS, në nivel tremujor, përkatësisht njëherë në tre muaj siç është përcaktuar me ligj, ku më pas publikohet Lista e azhurnuar e zgjedhësve. Gjithashtu, para zgjedhjeve, publikohet Lista e zgjedhësve, e cila është e azhurnuar, me qëllim kontrollim të të dhënave të cilat janë në të. Sistemi i tillë i publikimit të listës, funksionon shumë vite me radhë dhe është treguar si i mirë.
 - Promovimi i procedurave për kontrollim dhe azhurnim të qytetarëve në Listën e zgjedhësve dhe nxitje të qytetarëve, organizatave civile dhe partive politike që të kryejnë kontroll të vazhdueshëm në Listën e zgjedhësve në praktikë funksionon në mënyrë korrekte. Para çdo cikli të zgjedhjeve, KSHZ-ja shpall thirrje publike për kontroll në Listën e zgjedhësve. Interesi për kontroll të të dhënave nga ana e qytetarëve është i madh, në ekzemplarin elektronik, por edhe më atë të shtypur. Nëse nuk ka zgjedhje, lista azhurnohet, përkatësisht kontrollohet 2 herë në vit, nga ana e KSHZ-së.
 - KSHZ-ja realizon kontroll të vazhdueshëm të integritetit të bazës së të dhënave të listës së zgjedhësve përmes kontrollit të raporteve për letërnjoftimet dhe dokumentet e udhëtimit të sapolësuara biometrike, bazës për letërnjoftimet dhe dokumentet e sapolësuara të udhëtimit, si dhe përmes kryerjes së kontrollit në evidencat e MPB-së, si dhe në bazat e të dhënave dhe evidencat e organeve dhe institucioneve tjera shtetërore.
 - Lista e zgjedhësve për zgjedhjet lokale ishte i arritshëm për këqyrje publike nga 21.08.2017 dhe zgjati deri më 9.9.2017. Në Listën e zgjedhësve për zgjedhje lokale janë regjistruar 1,814,644 votues.
- **Zgjedhjet lokale 2017.**
 Në bazë të Deklaratës për konstatimet dhe konkluzionet e para të Misionit vëzhgues të OSBE/ODIHR-së mbajtja e Zgjedhjeve lokale më 15 tetor 2017 kontribuoi në forcimin e besimit në procesin demokratik. Zgjedhjet u mbajtën në mjedis konkurrues, me kandidatë që, në përgjithësi, mund të udhëhiqnin në fushatë pa kufizim, ndërsa liritë themelore u respektuan në mënyrë të përgjithshme.
 Mediat që ishin lëndë e monitorimit, siguruan mbulim të paanshëm të kandidatëve dhe e ndihmuan mundësinë për debat politik. Edhe krahas sfidave organizative, administrata zgjedhore siguroi që votuesit të mund ta realizojnë të drejtën e tyre të zgjedhësit. Dita e zgjedhjeve u zhvillua në mënyrë të rregullt, megjithëse u konstatuan disa parregullsi procedurale.
 Gjithsej 1.814.644 votues janë regjistruar për zgjedhje. Gjatë verifikimit online dhe personal të listës së zgjedhësve, u kërkuar vetëm një numër i vogël i ndryshimeve. Si rezultat, shumë vëzhgues ndërkombëtar shprehën besim në integritetin e listës së zgjedhësve, ndërsa disa edhe më tutje shprehën shqetësim rreth realizimit të kushtit për vendbanim.
 19 subjekte politike dhe 65 grupe votuesish propozuan gjithsej 258 kandidatë për kryetarë komune dhe 370 lista të kandidatëve për zgjedhjet lokale më 15 tetor 2017. Votuesve u ofrua spektër i gjerë për zgjedhje, e në disa komuna u mbajtën zgjedhje me numër më të madh të kandidatëve të paraqitur.
 Megjithëse rregullativa për financimin e fushatave është përmirësuar vitet e fundit, në pajtim me rekomandimet paraprake, ajo nuk siguroi transparencë të plotë adekuate për shkak të mungesës së revizionit të detyrueshëm të raporteve preliminare, si dhe për shkak autorizimeve të pamjaftueshme të Entit Shtetëror të Revizionit për

mbikëqyrje.

Monitorimi i mediave nga ana e OSBE/ODIHR-së treguan se mediat publike u siguruan të gjithë pjesëmarrësve kohë falas për transmetim gjatë terminëve të pikut të shikueshmërisë por vetëm një numër i vogël i kandidatëve e shfrytëzoi këtë. Të dy partitë më të mëdha dominuan në reklamimin e paguar në mediat private. U organizuan TV debate, por megjithatë jo të gjithë kandidatët e ftuar morën pjesë.

ASHAAM si organ përgjegjës për të siguruar mbulim të balancuar dhe të paanshëm të zgjedhjeve ngriti gjashtë procedura për kundërvajtje nga ana e mediave.

Ajo që vëzhguesit civil kishin qasje në të gjitha fazat e procesit kontribuoi në transparencën dhe ofroi vlerësim jopartiak të zgjedhjeve. Mbi 3000 vëzhgues i ndoqën ngjarjet në ditën e zgjedhjeve.

2. Kuvendi

Në pjesën e punës së Kuvendit, Qeveria u fokusua në mbështetjen e plotë ndaj të gjitha masave për kthimin e ambientit demokratik në këtë institucion kryesor, përmes dialogut politik dhe bashkëpunimit me të gjitha partitë parlamentare dhe veçanërisht me opozitën. Qeveria do të japë kontribut të saj në drejtim të sigurimit të kushteve për implementim të plotë të Rekomandimeve për të cilat u dakorduan pas ngjarjeve të padëshiruara nga 24/12/2012, lidhur me ngjarjet e dhunshme nga 27/04/2017. Qeveria, partnerët e koalicionit dhe shumica në Kuvend, në bashkëpunim të hapur dhe të sqartë me opozitën, kujdeset që funksioni mbikëqyrës i Kuvendit dhe trupave të Kuvendit mbi punën e Qeverisë dhe shërbimet e saj të sigurisë dhe zbulimit, të jetë i rregullt dhe në mënyrë rutinore, me shkallë më të lartë të mundshëm të transparencës dhe përfshirjes së përfaqësuesve nga shoqëria civile.

Statusi i realizimit të masave:

- Më 16.08.2017 Kryetari i Qeverisë i dërgoi letër Kryetarit të Kuvendit, në të cilin theksohet gatishmëria e qartë e Qeverisë për mbajtjen e pyetjeve javore, tematike të deputetëve në kohëzgjatje prej një orë e gjysmë, në kohë dhe në formatin që është më i përshtatshëm dhe në pajtim me procedurat e brendshme të Kuvendit.
 - Qeveria, përkatësisht partnerët e koalicionit dhe shumica në Kuvend, janë përgatitur në bashkëpunim të hapur dhe të sqartë me opozitën, të kujdesen që funksioni mbikëqyrës i Kuvendit dhe i trupave të Kuvendit mbi punën e Qeverisë dhe shërbimet e saj të sigurisë dhe zbulimit, të jetë i rregullt dhe në mënyrë rutinore.
 - Në nenin 122, paragrafi 2 i Rregullores së Kuvendit është përcaktuar se trupat punues mund në mbledhjet të ftojë persona profesionalë dhe ekspertë nga sfera të caktuara dhe nga institucione dhe shoqata tjera për t'u prononcuar për çështje që shqyrtohen në mbledhjet e trupave punues. Kjo mundësi në punën e deritanishme të trupave punues, aplikohet. Gjithashtu, Qeveria obligohet dhe pranon elaborim të detyrueshëm të propozim-ligjeve, para trupave të Kuvendit, në nivel të ekspertëve.
 - Në drejtim të hapjes së Kuvendit për sektorin joqeveritar, ishte nikoqir në 2 evenimente të organizuara me organizatat civile. Në vijim e sipër është aktivimi i veglës së re, të ashtuquajtur "e-Dritare" qo do t'u mundësojë qytetarëve të paraqiten për prezencë në seancat plenare. Gjithashtu, u shtua edhe një vegël e re përmes së cilës qytetarët do të mund të njoftohen veçanërisht me aktivitetet e deputetëve të shënuar me emrin "Takime".
 - Në shtator, KRM-ja e përtëriu Grupin parlamentar ndërpartiak për të drejtat e personave me handicap (GPNP), në bashkëpunim me Polio plus. Gjithashtu, për herë të parë, Kuvendi vendosi Klub për çështje dhe politika të rinjve. Klubi është trup joformal, i formuar nga anëtarë të të gjitha partive parlamentare qëllimi i të cilit është realizimi i interesave të rinjve në vend, në bashkëpunim me organizatat e rinjve, grupet joformale të rinjve dhe brezat e rinj partiakë.
 - Nga ana tjetër, në letrën Kryeministri, Qeveria obligohet se shumica parlamentare do të angazhohet edhe për përfshirje më të madhe adekuate të shoqërisë civile në diskutime në trupat punues.
 - Qeveria angazhohet në mënyrë aktive edhe për përfshirjen e Kuvendit në reformën e shërbimeve të zbulimit dhe sigurisë.
 - Në letrën Qeveria gjithashtu obligohet për mbështetje të plotë për masat me qëllim kthimin e ambientit demokratik në atë institucion kryesor, përmes dialogut politik dhe bashkëpunimit me të gjitha partitë parlamentare, përfshirë edhe opozitën.
 - Në mbledhjen e Kuvendit të mbajtur më 14.07.2017 u miratua vendimi për formimin e Këshillit Nacional për

Eurointegritet. U zgjodh kryetari (nga opozita) dhe zëvendëskryetari. U formuan 21 komisione, prej tyre me 10 kryeson opozita (VMRO-DPMNE, PSM, BESA), e me 11 kryeson pozita (LSDM, BDI, përfshirë edhe deputetët e pavarur). Në mbledhjen e parë të KNEI të mbajtur më 20 shtator 2017, u diskutua për aktivitetet e realizuara të Qeverisë dhe planet e ardhshme në pjesën e reformave të lidhura me procesin e integritetit evropian.

- Komisioni për Mbikëqyrje të Punës së Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim dhe Agjencisë për Zbulim mbajti mbledhje më 04.07.2017, në të cilën u miratua Rregullorja e punës. Më 19.07.2017 në Kuvend u mbajt takimi i përbashkët i të dy komisioneve parlamentare për mbikëqyrje të punës së shërbimeve të sigurimit dhe zbulimit, me ekspertët e Komisionit Evropian të udhëhequr nga R. Pribe. Në takimin u bisedua për mbikëqyrjen e Kuvendit dhe për implementimin e rekomandimeve. Në takimin të pranishmit u pajtuan se bashkërisht do të punojnë në përbushjen e rekomandimeve. Kryetarët e të dy komisioneve theksuan se do të japin kontribut më të madh në të gjitha sferat për të cilat janë kompetentë komisionet.
 - Më 30.08.2017 u mbajt mbledhja e dytë e Komisionit. Mbledhja u mbyll për opinionin për shkak të informatave të klasifikuara në dokumentet, Komisioni diskutoi për Raportin e punës së DSK-së dhe AZ-së për vitin 2016.
 - Më 18.09.2017 u mbajt mbledhja e Komisionit për Mbikëqyrje të Punës së Drejtorisë për Zbulim dhe Kundërzbulim dhe Agjencisë për Zbulim, ku u shqyrtua Informata për nevojën e formimit të Grupit punues ndërrresorial për përgatitjen dhe ndjekjen e implementimit të Planit për realizimin e rekomandimeve të grupit të ekspertëve të lartë për çështje sistemore nga sundimi i të drejtës në lidhje me ndjekjen e komunikimeve. Komisioni caktoi dy anëtarë që do të marrin pjesë në punën e grupit punues ndërinstitucional.
- Komisioni për Mbikëqyrje të Zbatimit të Masës së Veçantë Hetuese Ndjekje të Komunikimeve nga ana e MPB-së, Drejtoria e Policisë Financiare, Drejtoria Doganore dhe Ministria e Mbrojtjes, më 18.07.2017 e mbajti mbledhjen e parë në të cilën u miratua Rregullorja punën e komisionit. Në mbledhjen ishin të pranishëm përfaqësuesit e MPB-së, Drejtoria e Policisë Financiare, Drejtoria Doganore dhe Ministria e Mbrojtjes.
- Mbledhja konstituive e Klubit të femrave deputete u mbajt më 6 korrik 2017. Klubi do të veprojë për iniciimin e zgjidhjeve ligjore për arritje të barazisë gjinore dhe avancim të të drejtave të femrave, përfshirje të tyre aktive në procesin e vendimmarrjes në shtetin si dhe forcimin dhe zgjerimin e demokracisë në të gjitha sferat e shoqërisë. Klubi i deputeteve më 20.07.2017 mbajti takim me temë "Klubi i deputeteve, arritjet dhe prioritetet". Më 27.07.2017 u mbajt mbledhja e dytë.
 - Klubi, në kuadër të kompetencave të tij, reagoi dhe e gjykoj sjelljen diskriminuese ndaj femrave-pjesëmarrëse në Maratonën ndërkombëtare të atletëve në Ohër, ku shpërblimet e femrave garuese, janë më të ulëta se ato për meshkujt garues. Gjithashtu, gjatë muajit gusht punoi në përpilimin e Propozim-Deklaratës për përfshirje të më shumë grave kryetare komunash në Republikën e Maqedonisë. Më 21-22 shtator, klubi mbajti punëtori me temë: "Ndërtojmë ura mirëkuptimi" në të cilin morën pjesë anëtarë të Klubit të deputeteve të Kuvendit.
- Në mbledhjen e Komisionit të Përhershëm Anketues për të Drejtat e Njeriut të mbajtur më 14.07.2017 u zgjodhën kryetari dhe zëvendëskryetari i Komisionit me çka u kompletua përbërja.
 - Kryetari i Komisionit të Përhershëm Anketues për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Qytetarit, më 14.09.2017, mbajti takim me NDI, ku u diskutua për çështjet prioritare për shqyrtim në mbledhjet e ardhshme, organizim të vizitave në terren të shtëpive ndëshkimore-korrigjuese, institucioneve për sëmundje shpirtërore, Qendrës strehimore për azilkërkuesit dhe tjerë, si dhe organizim të shënimit të 10 dhjetorit - Dita ndërkombëtare për drejtat e njeriut, në Kuvend.

3. Emërimet

Qeveria do të bëjë çmos për të siguruar bashkëpunim me **Presidentin e Republikës së Maqedonisë**, si dhe për funksionimin e papenguar të të gjitha institucioneve shtetërore me respektim të plotë të obligimeve të definuara kushtetuese dhe ligjore dhe kompetencave të tyre.

Statusi i realizimit të masave:

- Kanë filluar konsultimet me Presidentin e Republikës së Maqedonisë për plotësimin e vendeve të zbrazura në përfaqësitë diplomatike. U realizuan disa takime.
- Nga ana e Kryetarit të Kuvendit të RM-së u shpallën dy shpallje për zgjedhje të dy anëtarëve të Këshillit të prokurorëve publikë dhe atë e para më 07.06.2017 ndërsa e dyta më 18.08.2017. Afati për parashtrimin e fletëparaqitjeve për të dyja shpalljet ka përfunduar (afati për shpalljen e parë më 22.06.2017, dhe afati për shpalljen e dytë më 04.09.2017). Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve duhet të mbajë mbledhje në të cilën do të përcaktojnë propozime për dy anëtarë të Këshillit nga paraqitjet e parashtruara.
- Duhet të zgjidhen 3 anëtarë të Gjykatës Kushtetuese të cilëve u skadon mandati nga të cilët për 1 në korrik, ndërsa për 2 në tetor. Për zgjedhje të një gjykate të Gjykatës Kushtetuese të RM-së, në kompetencë të Kuvendit, Komisioni për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve të Kuvendit, duhet të mbajë mbledhje në të cilën do të përcaktojë propozim për gjykatës të Gjykatës Kushtetuese. Propozimi për zgjedhje të dy gjykatësve tjerë kushtetues është në kompetencë të Presidentit të Republikës së Maqedonisë.

4. Implentimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit

Qeveria, në frymën e kohezionit, e rumbullakon implementimin e elementeve legjislative të **Marrëveshjes së Ohrit**.

Statusi i realizimit të masave.

- Qeveria në mbledhjen e 20-të të mbajtur më 04.08.2017 e miratoi tekstin e Propozim-ligjit për përdorimin e gjuhëve. Pasi të miratohet ligji në Kuvend, Ministria e Drejtësisë, përmes Ministrisë së Punëve të Brendshme, do ta dorëzojë ligjin dhe çështjet e hapura që nuk janë pjesë e këtij ligji, në Komisionin e Venedikut dhe do të kërkojë mendim për pakon e zgjedhjeve ligjore. Më 7.09.2017 propozim-ligji u votua në Komisionin për Çështje Evropiane në KRM-në. Pastaj, për propozim-ligjin u zhvillua debat në Komisionin Juridik-Legjislativ (mbledhja nr. 12 më 12.09.2017), Komisionin për Sistem Politik dhe Marrëdhënie ndërmjet Bashkësive (mbledhja nr. 8. Më 13.09.2017). Procedura parlamentare është në rrjedhë. Ligji është në debat plenar nga 13.9.2017, dhe më 15.11.2017 kaloi në lexim të parë.

5. Shoqëria civile

Shoqërinë civile, Qeveria e trajton si partner të barabartë dhe korrektor të vendimeve të saj, me të drejtë të plotë, shoqëria civile të participojë në ndërtimin e politikave, të sugjerojë dhe kritikojë. Qeveria ka për qëllim që dialogu me shoqërinë civile të zhvillohet vazhdimisht, të jetë transparent dhe tërësisht inkluziv.

Statusi i realizimit të masave:

- Në lidhje me Vendimin për formimin e Këshillit për bashkëpunim ndërmjet Qeverisë dhe sektorit civil, nga viti 2016., Sekretariati i përgjithshëm më 13.07.2017 organizoi takim këshillimor me përfaqësuesit e mekanizmit IPA2 dhe me grupin joformal nga 89 organizata civile. Raporti nga takimi është publikuar në ueb faqen e Seksionit për bashkëpunim me OJQ-në www.nvosorabotka.gov.mk bashkë me thirrje të SHQ-së për dorëzim të propozimeve për ndryshimin e Vendimit, më së voni deri më 15.09.2017. Konsultime plotësuese do të organizohen pas përpunimit të Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për formim të Këshillit.
- U përgatit Raport për masat dhe aktivitetet e ndërmarrë nga Plan-veprimi për zbatimin e Strategjisë për bashkëpunim të Qeverisë me sektorin civil (2012-2017). Në pajtim me konsultimet me institucionet kompetente,

një pjesë e masave dhe aktiviteteve do të vazhdojnë të realizohen edhe në periudhën 2018-2020, për një pjesë të masave të përcaktuara është përfshirë vlerësimi për aktualitetin e tyre ose për nevojën për analizë plotësuese. Raporti është shqyrtuar nga Qeveria më 19.9.2017 dhe është publikuar në www.nvosorabotka.gov.mk në pjesën Realizimi i Strategjisë.

- Në mbledhjen e Qeverisë të mbajtur më 15.08.2017 u miratua Rregullorja për ndryshimin e Rregullores për punën e Qeverisë, me çka u rrit numri minimal i ditëve për konsultime të RVEN nga 10 në 20 ditë.
- Qeveria në mbledhjen e mbajtur më 4.07.2017 shqyrtoi Informatë për procesin e vlerësimit të ndikimit të rregullativës (PNR) dhe miratoi konkluzione me të cilat ngarkohen të gjitha ministritë t'i respektojnë procedurat e PNR dhe publikimin e PNR. Në pajtim me Rregulloren për punën e Qeverisë dhe sistemin e e-qeverisë, në mbledhjet e trupave punues dhe Qeverisë shqyrtohen materiale të cilat i përmbajnë mendimet e nevojshme në pajtim me nenin 68 të Rregullores, përfshirë edhe mendimin e Ministrisë për shoqëri informatike dhe administratë për propozimet e ligjeve të cilat i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit të rregullativës (PNR).
- Në korrik 2017 në ueb faqen e Seksionit për bashkëpunim me OJQ-në të Sekretariatit të përgjithshëm www.nvosorabotka.gov.mk, në pjesën e Mbështetjes financiare, është publikuar pasqyrë e detajuar tabelore e mjeteve të ndarë për mbështetjen e organizatave civile nga ana e Qeverisë, sipas viteve, për periudhën 2012-2016. Baza e të dhënave ofron mundësi për kërkim sipas emrit të shoqatave, projektit dhe vitit të mjeteve të ndarë dhe do të azhurnohet rregullisht.

6. Mediat

Në pjesën e **mediave** Qeveria ndërton partneritet me asociacionet dhe sektorin civil, me qëllim të lirimit të hapësirës mediatike nga çfarëdo ndikime institucionale ose personale, përfshirë edhe nga varësia financiare. Qeveria e stopon reklamimin komercial, do ta përforcojë dhe profesionalizojë tërësisht servisin radiodifuziv publik dhe i hap informatat për opinionin të cilat janë të karakterit publik dhe interesit publik.

Statu i realizimit të masave:

- Qeveria në mbledhjen e mbajtur më 05.09.2017 miratoi Konkluzion me të cilin e miratoi Deklaratën në vijim: Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe institucionet e saj shprehin vullnet dhe mbështetje të fuqishme politike për zbatimin e vazhdueshëm të kodit etik për njoftim mediatik dhe e inkurajojnë fuqimisht zbatimin dhe respektimin e sistemit për vetërregullim mediatik.
 - Qeveria në mbledhjen e mbajtur më 22.08.2017 miratoi konkluzion sipas të cilit ngarkohen të gjitha organet e administratës shtetërore, u sugjerohet institucioneve që nuk kanë status të organeve të administratës shtetërore dhe u rekomandohet njësisive të vetëqeverisjes lokale të ndërpresin të emitojnë, përkatësisht reklamojnë fushata/spote në hapësirë të paguar në radiodifuzerë komercialë elektronikë – televizione dhe radio, gazeta ditore dhe javore, bilborde, internet portale, me përjashtim të mediave sociale.
- Më 24.09.2017, zëdhënësi i Qeverisë mbajti konferencë shtypi ku u publikuan shpenzimet për reklamim të Qeverisë për periudhën 2008-2015. Në lidhje me ndarjen e parave, siç u sqarua në konferencë shtypi, të paqarta janë kriteret se si janë transferuar paratë për marrje me qira të hapësirës për reklama te koncesionerët nacionalë komercialë, megjithëse pasqyra tabelore e prezantuar në konferencën për media, tregon se rejtingu nuk ka luajtur kurrfarë roli dhe se kriteret thjesht nuk kanë ekzistuar. Në mënyrë plotësuese, në konferencën e shtypit më 16.09.2017 në përputhje me analizën e shpenzimeve për tërheqje të investimeve të huaja të drejtpërdrejta në 10 vitet e fundit, u prezantuan edhe shpenzimet që u janë paguar mediave maqedonase.
- Diskutimi i parë publik me temë reforma mediatike u mbajt më 14 korrik 2017, ku morën pjesë ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës dhe ministri pa portofol i ngarkuar për komunikime, llogaridhënie dhe

transparencë. Më 23.06.2017 Ministri pa portofol mori pjesë në konferencën kushtuar reformave në sektorin mediatik të organizuar nga MIM me mbështetje të BE-së. U mbajtën edhe disa takime me përfaqësues të Delegacionit të BE-së me temë. Ministrat realizuan edhe disa takime të veçanta me përfaqësues të mediave dhe shoqatave mediatike, si dhe me përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar.

- Pas konsultimeve të mbajtura publike për reforma mediatike u dërgua thirrje të gjithë palët e prekur për dorëzim propozim-ndryshime të Ligjit për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike. Në bazë të komenteve dhe propozimeve të marrë, MSHIA në koordinim me ministrin pa portofol i ngarkuar për komunikime, llogaridhënie dhe transparencë, përgatiti propozim-tekst të Ligjit për ndryshime dhe plotësime të Ligjit për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike, i cili u dorëzua të gjithë palët e prekur dhe u vendos në ueb faqen e MSHIA. Afati për dorëzimin e komenteve nga palët e prekur për propozim-tekstin e Ligjit ishte deri më 11.09.2017. Pas kësaj, do të mbahet edhe një diskutim publik dhe nëse nevojitet, Propozim-ligji do të revidohet përsëri, para se të hyjë në procedurë normale.
- Propozim-ligji iu dorëzua edhe Komisionit Evropian edhe OSBE-së. Pritet në tetor të përpunohet analiza e Propozim-ligjit e përpunuar nga analisti i OSBE-së i cili punon në sferën e mediave. Nëse nevojitet, Propozim-ligji do të revidohet përsëri, para se të hyjë në procedurë normale (që do të përfshijë edhe publikim në RVEN),
-Në mbledhjen nr. 12 të Kuvendit të mbajtur më 19.09.2017, u pranuan me procedurë të shkurtuar ndryshimet në Ligjin për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike me çka u hoq obligimi që qytetarët dhe firmat të paguajnë taksë radiodifuzive. RTM-ja do të mbështetet financiarisht nga buxheti shtetëror me ndarje vjetore prej 0.5% nga buxheti. Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në Gazetën zyrtare.
- Në bazë të Raportit të përpiluar nga Ministria e Punëve të Brendshme për periudhën nga viti 2013 deri në korrik 2017 për raste të regjistruara të sulmeve fizike dhe verbale dhe presione mbi gazetarët, janë parashtruar gjithsej 44 paraqitje nga qytetarët ose mediat për sulme fizike mbi gazetarët, rrezikim të sigurisë në lloj të kërcënimit nga çfarëdo lloji ose gjuhë të urrejtjes. Pjesa më e madhe e paraqitjeve janë në rajonin e Shkupit - 28, pastaj Ohrit - 14, dhe dy ankesa në rajonin e Strumicës.
- Më 17.08.2017 në Qeverinë u mbajt brifing para gazetarëve dhe redaktorëve, ku u prezantuan idetë për punën e Sektorit për komunikime, qo dë të funksionojë si servis për qytetarët dhe mediat. Agjenda ditore e mbledhjeve të Qeverisë, konkluzionet dhe njoftimet publikisht dhe në mënyrë transparente publikohen në ueb faqen. Pas çdo mbledhje të Qeverisë mbahen brifingje me qëllim që menjëherë të informohet opinioni për punën e Qeverisë.

7. Reforma në administratën publike

Reforma në administratën publike (RAP), në afat të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë është një prej prioriteteve kryesore të Qeverisë, me ç'rast do të fillojë me definimin e Strategjisë cilësore dhe gjithëpërfshirëse për RAP, në drejtim të depolitizimit të plotë dhe profesionalizimit të administratës, dhe ndërtim të administratës cilësore dhe shërbyese e cila do të funksionojë dhe punojë në kushte të përmirësuara të punës, duke i shfrytëzuar të gjitha mundësitë e qasjes bashkëkohore përmes e-qeverisë, e-shërbimeve dhe interoperabilitetit.

Statusi i realizimit të masave:

- Qeveria në mbledhjen e 8-të, të mbajtur më 22.06.2017 miratoi konkluzion me të cilin i ngarkoi të gjithë ministrat t'i deklasifikojnë të gjitha informatat/të dhënat të cilat janë të lidhura me shpenzimet për udhëtime zyrtare dhe shpenzimet për reprezentacion në vetë ministrinë (në të ardhmen, si dhe nga periudha paraprake), përveç të dhënave të cilat duhet të mbeten të mbrojtura në pajtim me rregullat ligjore (për shkak të strukturave të sigurisë, shërbimeve dhe ngjashëm).
- Qeveria në mbledhjen e 25-të, të mbajtur më 29.08.2017 miratoi konkluzion për t'u deklasifikuar informatat e

miratuara nga Qeveria të cilat janë me interes publik dhe që kanë të bëjnë me marrëveshjet për ndarje të ndihmës shtetërore.

- Gjithashtu, janë ngarkuar drejtorët e Agjencisë për investime të huaja dhe Drejtorisë për zona zhvillimore industriale teknologjike t'i deklasifikojnë informatat të cilat paraprakisht janë klasifikuar nga institucioni i tyre, e kanë të bëjnë me informatat dhe marrëveshjet për ndarje të ndihmës shtetërore.

- Më 17.08.2017 Zëvendëskryetari i Qeverisë i ngarkuar për çështje evropiane, mbajti takim me Komisionin për Qasje të Lirë në Informatat me Karakter Publik, me ç'rast u diskutua për mundësitë dhe efektet nga anulimi i Vendimit për përcaktimin e kompensimit për shpenzime materiale për informatën e dhënë, nga poseduesit e informatave. Qeveria do të insistojë ta zgjedhë zgjidhjen më rationale e cila do të jetë më e volitshme për opinionin. Në mbledhjen e 28-të të QRM-së të mbajtur më 19.09.2017, u miratua vendimi me të cilin hiqet kompensimi për dërgim të informatave me interes publik, në lloj të shënimit elektronik të informatave në USB, ose në email adresën e kërkuarve.
- Regjistri (Lista) e poseduesve azhurnohet rregullisht. Më 24 gusht 2017 u dërgua Qarkore për azhurnimin e të dhënave, me qëllim që personat përgjegjës dhe zyrtarë të evidentuar në Regjistrin e poseduesve të informatave me karakter publik, të publikuara në ueb lokacionin e Komisionit, të përkujtohen në obligimin që del nga nenet 8 dhe 9 të Ligjit për qasje të lirë në informatat me karakter publik. Afati për dorëzim të të dhënave për personin zyrtar, emërtimi i saktë dhe adresa e institucionit, telefoni kontaktues, email adresa, adresa e ueb faqes, si dhe për mënyrën në të cilën lista e informatave është e arritshme për qytetarët është 12.09.2017. Qarkorja u është dërguar edhe në formë elektronike 1259 personave në Listën e poseduesve për vitin 2016. Komisioni deri më 05.10.2017 i regjistroi dhe i evidentoi ndryshimet të poseduesit e informatave me çka janë bërë ndryshime dhe korrigjime për gjithsej 831 posedues dhe janë azhurnuar edhe të dhënat e 132 personave të emëruar zyrtarë.
- Në pajtim me angazhimet dhe transparencën e shprehur për punën e Qeverisë, në ueb faqen e Qeverisë është krijuar seksioni i ri "Mbledhjet e Qeverisë" <http://vlada.mk/vladini-sednici> me të cilin është mundësuar arritshmëri në agjendat ditore dhe procesverbalet e miratuara nga mbledhjet e Qeverisë (konkluzionet e miratuara për pikat e agjendës ditore). Kjo risi më 17.08.2017 është publikuar zyrtarisht dhe është promovuar në mediat.
- Nëngrupet punuese për përpunim plotësues të Strategjisë për RAP dhe Plan-veprimin mbajnë takime rregullisht. Ka filluar procesi i revidimit të pjesës narrative të Strategjisë. I njëjti do të përfundojë deri në fund të tetorit, ku përsëri do të caktohen takime të nëngrupeve punuese në të cilat do të shqyrtohet teksti. Gjatë muajit tetor, koordinatorët e nëngrupeve punuese punuan bashkërisht me ekspertë të SIGMA në revidimin e Plan-veprimin dhe shpenzimeve për Strategjinë, të cilat gjithashtu do të shqyrtohen në takime me anëtarët e nëngrupeve punuese.
- Në mbledhjen e 36-të të Qeverisë të mbajtur më 7.11.2017, u miratua Propozim-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për nëpunës administrativë me të cilin në masë të madhe thjeshtohen procedurat për avancimin dhe përsosjen e të punësuarve në administratën shtetërore.
- Procedura për azhurnimin e Regjistrin të të punësuarve në sektorin publik ka filluar, punohet në revizionin si dhe në mbledhjen e të dhënave. Më 13 gusht në konferencën e shtypit u prezantuan një pjesë e të dhënave. Pas informatave të marrë në lidhje me gjendjen e të dhënave që janë futur në Regjistrin, ekipi nga MSHIA punon në kontrollin e brendshëm preliminar të të dhënave.
- Draft-teksti i ri i Programit për menaxhim me financat publike 2018-2021 u finalizua dhe i njëjti iu dorëzua në formë elektronike Delegacionit të BE-së më 19 korrik 2017. Dialogu publik me palët e interesuar (sektori civil, akademia, shoqata) u realizua më 19.09.2017. Pas konsultimit të mbajtur dhe pas komenteve të marrë, do të

vijojë revidimi i tekstit të programit me ç'rast pritet miratimi i tij deri në fund të vitit 2017.

8. Reformat gjyqësore

Në pjesën e **reformave gjyqësore**, Qeveria i pranon vërejtjet dhe rekomandimet e Komisionit Evropian dhe Këshillit të Evropës (Komisioni i Venedikut dhe GREKO), me çka në afat të shkurtër, të mesëm dhe të gjatë obligohet të ndërtojë një sistem të pavarur, të paanshëm, profesional dhe efikas gjyqësor. Në afat të shkurtër, Qeveria bën revizion të plotë të Draft-Strategjisë për reforma në sistemin e jurisprudencës dhe do të ndërtojë atmosferë të gjyqësisë së lirë, pa presione politike, me qëllim të sigurimit të hapësirës edhe për ndryshime të nevojshme ligjore në afat të mesëm dhe të gjatë.

- Me aktvendim të ministrit të Drejtësisë më 17.07.2017 është formuar Këshilli për reforma në sektorin e jurisprudencës i cili është kompetent t'i koordinojë dhe ndjek reformat në sektorin e jurisprudencës. Deri më tani janë mbajtur 5 mbledhje në të cilat Këshilli e shqyrtoi Projekt-strategjinë për reforma në sektorin e jurisprudencës dhe Planin Aksional, që është miratuar në mbledhjen e fundit. Gjithashtu, në mbledhjen e fundit, Këshilli i shqyrtoi ndryshimet e ligjeve të cilat janë paraparë në kornizat e gjyqësisë – Ligji për Këshillin për përcaktimin e fakteve dhe përgjegjësisë disiplinore të gjykatësve dhe përgatitja e ndryshimeve dhe plotësimeve të Ligjit për këshillin gjyqësor.
- Më 22.09.2017 është formuar Grupi i Punës për kontroll në funksionimin e sistemit informatikë (AKMIS) me qëllim të qasjes së autorizuar në AKMIS për shkak të kontrollit në të dhënat dhe kontrollit në punën e tanishme të sistemit informatikë, përdorimi i drejtë, shpërndarja automatike, përcaktimi i keqpërdorimit eventual dhe përgjegjësia dhe mbikëqyrja mbi zbatimin e dispozitave të Rregullores Gjyqësore. Grupi është i përbërë prej 8 personave (MD, personat e TI-së nga MD-ja, GJTH Kavadarci, KGJRM, GJA Shkup, gjykatësit e GJTH Kavadarci, GJA Shkup). Sipas nevojës do të përfshihen përfaqësuesit ndërkombëtarë. Deri më tani GP-ja ka kryer dy inspektime në GJTH Shkupi 1 në Shkup, për çka kryetari i gjykatës është informuar me kohë. Inspektimi do të vazhdojë edhe në Gjykatën Supreme, gjykatat e apelit dhe gjykatat tjera me zgjedhje të rastësishme. Njëkohësisht, do të angazhohen edhe revizorë të pavarur që të kryejnë revizion në punën e AKMIS-it.
- Në pajtim me Strategjinë për reforma në sektorin e jurisprudencës për vitet 2017-2022, planifikohet përforcimi në punën e PSP-së, si institucion i pavarur në kornizat e PPRM-së. Kompetencat e tyre do t'u referohen rasteve lidhur me rastet e korrupsionit të cilat dalin nga materialet e përgjuara. Me ndryshimet e reja të Ligjit për prokurori publike, do të mundësohet vazhdimi i punës së Prokurorisë Speciale Publike. Në pajtim me këtë, PSP-ja do të transformohet në zyrën e PSP-së me kompetenca të pavarura në kornizat e Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë.
- Me aktvendimin e ministrit të Drejtësisë më 01.08.2017 është formuar Grupi i Punës për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve. Është hartuar Propozim-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve. Më 07.08.2017 është dorëzuar njoftimi i ENER-it për fillimin e procesit për përgatitjen e ndryshimeve të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve. Më 01.11.2017, Propozim-ligji është publikuar në ENER për konsultime, në pajtim me afatin prej 20 ditësh.
- Me aktvendimin e ministrit të Drejtësisë më 30.08.2017 është formuar Grupi i Punës për hartimin e Propozim-ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve, i përbërë nga përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Prokurorisë së Lartë Publike në Shkup, Prokurorisë Publike për ndjekjen e veprave penale të lidhura dhe të cilat rezultojnë nga përmbajtja e ndjekjes

së paligjshme të komunikimeve dhe profesorët e Fakultetit Juridik. Propozim-ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve është hartuar. Më 28.09.2017 është dorëzuar njoftimi i ENER-it për fillimin e procesit për përgatitjen e Propozim-ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve. Më 16.10.2017 në ENER është publikuar Projekt-raporti për VNR-në me Propozim-ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e dëshmitarëve, për konsultime në afat prej 20 ditësh në pajtim me Rregulloren e Qeverisë. Më 17.10.2017 është dorëzuar në mendim në Komisionin e Venedikut, i cili do të shqyrtohet në sesionin e dhjetorit.

- Aktet e përgjithshme për sistematizimin e vendeve të punës së Avokatit të Popullit u miratuan në seancën e Kuvendit të mbajtur më 11.07.2017. Në këtë drejtim janë miratuar edhe mjetet nga Ministria e Financave për gjashtë (6) punësime të reja në zyrën e Avokatit të Popullit deri në fund të vitit.
- Në bashkëpunim me ekspertët e IPA projektit 2011 „Përforcimi i sundimit të së drejtës“, është përgatitur Strategjia për Teknologjinë Informatike në sektorin e jurisprudencës për vitet 2018-2023. Në hartimin e Strategjisë u përfshinë përfaqësuesit e më tepër institucioneve¹. Draft-strategjia është dërguar në komentime të gjithë anëtarët e GP-së më 13.10.2017. Pas përfundimit të konsultimeve me të gjitha institucionet pritet të miratohet nga QRM-ja në dhjetor 2017.

9. Reforma në shërbimet e zbulimit dhe të sigurisë

Qeveria konsideron se **reforma në shërbimet e zbulimit dhe të sigurisë** është më se e domosdoshme. Duke pasur parasysh se bëhet fjalë për reformë gjithëpërfshirëse, Qeveria do të sigurojë punë transparente dhe inkluzive, në të cilin procesi i konsultimeve do të zbatohet në mënyrë përkatëse. Reformat do të zbatohen konkretisht dhe në terren, pasi do të sigurojmë fotografinë e pastër, planin dhe dinamikën për ndryshimet e nevojshme, me të cilin do t'i mënjanojmë shkaqet për dobësitë e paraqitura në mekanizmin e sigurisë dhe shërbimeve për siguri dhe zbulim dhe do ta kthejmë besimin në to.

Statusi i realizimit të masave:

- Pas konsultimeve intensive në kornizat e Ministrisë së Punëve të Brendshme për modelin për reforma në sistemin e zbulimit dhe të sigurisë ky është zgjedhur nga Qeveria më 12.09.2017.
- Qeveria më 31.10.2017 miratoi Vendim me të cilin formohet Grupi i Punës i përbërë nga përfaqësuesit e të gjitha institucioneve të përfshira, opinionit shkencor dhe profesional, si dhe përfaqësuesit e dy komisioneve kuvendore për Mbikëqyrje mbi Punën e DSK-së dhe AZ-së dhe Mbikëqyrje mbi Zbatimin e Masës së Veçantë Hetuese Ndjekja e Komunikimeve. Grupi i Punës është kompetent ta hartojë Planin për realizimin e rekomandimeve të ekspertëve të Komisionit Evropian të udhëhequra nga R. Pribe për çështjet sistematike nga sundimi i së drejtës në lidhje me ndjekjen e komunikimeve (2015), si dhe ta koordinojë dhe ndjek zbatimin e tyre të mëvonshëm. Mbledhja e parë u mbajt më 13.11.2017 dhe është përgatitur Projekt-plani i cili është dorëzuar për vërejtje te anëtarët e Grupit të Punës.
- Në rrjedhë janë konsultimet me institucionet të cilat janë përfshirë në projektin për Qendrën Koordinuese Nacionale për luftën kundër krimit të organizuar dhe vlerësimit të shkallës së përgatitjes për funksionim. Aktet juridike të domosdoshme për funksionimin e kësaj qendre janë hartuar, janë siguruar hapësirat përkatëse, është bërë vlerësimi për përgatitjen e institucioneve për operacionalizim. Selia e QKN-së do të jetë në MPB. Në rrjedhë është pajisja e Qendrës Koordinuese Nacionale, njëkohësisht është siguruar linja e ADSL-së.

¹¹ MD, Gjykata Supreme, gjykatat, KGJRM, PPRM, Drejtoria për Realizimin e Sanksioneve, AGJPP, Shoqata e Avokatëve, Shoqata e Noterëve, përfaqësuesit e përmbauesve dhe ndërmjetësuesve

- Propozimi për modelin për mekanizimin e pavarur të jashtëm në punën e policisë të miratuar nga Qeveria më 12.09.2017. Në pajtim me modelin e miratuar për mekanizimin e jashtëm, në Prokurorinë Publike Themelore për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit do të formohet seksioni i veçantë i cili do të jetë kompetent për ndjekjen e veprave penale të kryera nga të punësuarit në MPB dhe pjesëtarët e policisë së burgut.
-Gjithashtu, te Avokati i Popullit do të formohet seksioni i veçantë në të cilin krahas personave profesionalë do të participojnë edhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare.
-Është përkufizuar edhe korniza ligjore e cila është e domosdoshme për vendosjen e mekanizmit të jashtëm. MD-ja dhe MPB-ja deri në mesin e dhjetorit 2017 obligohen në Qeveri t'i dorëzojnë propozim-tekstet e ndryshimeve ligjore me qëllim të miratimit të tyre.
- Qeveria në mbledhjen e mbajtur më 4.8.2017 miratoi Vendim për emërimin e koordinatorit nacional për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, si dhe Vendimet për emërimin e zëvendëskoordinatorit nacional për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe zëvendëskoordinatorit nacional për luftën kundër terrorizmit. Vendimet janë botuar në „Gazetën Zyrtare të RM-së“ numër 110 nga 14.8.2017.
- Qeveria miratoi Aktvendim për emërimin e anëtarëve, zëvendësanëtarëve dhe sekretarëve të Komitetit Nacional për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit në mbledhjen e mbajtur më 04.08.2017. Vendimi për formimin e Komitetit Nacional për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën Kundër Terrorizmit është botuar në „Gazetën Zyrtare të RM-së“ numër 98 nga 01.08.2017.

10. Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit

Qeveria angazhohet që luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit prej letrës ta nxjerr në praktikë, me lirim e mekanizmave nga ndikimet dhe presionet politike. Përkufizuar dhe do të zbatohet reforma të cilat do të sigurojnë marrëdhënie objektive dhe profesionale ndaj çdo rasti të paraqitur për korrupsion, me qasje të barabartë dhe zbatimin e ligjeve për çdo qytetar të Republikës së Maqedonisë. Këtë do ta bëjmë në mënyrë transparente dhe me respekt të plotë për të gjitha rekomandimet të cilat vijnë nga ekspertët e huaj dhe vendorë dhe nga shoqëria civile.

Statusi i realizimit të masave:

- Në rrjedhë është përkufizimi i masave konkrete për reformë në Seksionin për Luftën Kundër Korrupsionit në MPB me ç'rast fokusi është në trajnimet e specializuara dhe përf forcimin e kapaciteteve të të punësuarve.
- Në bazë të Raportit të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Qeveria do të propozojë masa të mëtejshme për përf forcimin e tij.
- Qeveria e RM-së, në mbledhjen numër 22 (09.08.2017) miratoi Vendim për përgatitjen e Strategjisë së Republikës së Maqedonisë për përf forcimin e kapaciteteve për mbajtjen e hetimeve financiare dhe konfiskimin e pronës, me Planin Aksional për zbatimin e saj, të cilën duhet ta përgatitin Ministria e Financave në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Publike, Drejtorinë e Doganave, Drejtorinë e Policisë Financiare dhe Drejtorinë për Zbulim Financiar.
-Strategjia do të miratohet deri në fund të vitit 2017 dhe do të përmbajë sistem gjithëpërfshirës të masave institucionale juridike të cilat janë të domosdoshme për përf forcimin e kapaciteteve të përgjithshme nacionale për mbajtjen e hetimeve financiare dhe konfiskimin e pronës

11. Migrimet

Në pjesën e **migrimeve**, Qeveria i filloi negociatat me Komisionin Evropian për Marrëveshjen e Statusit për (FRONTEKS) Shërbimin Evropian për Rojën Kufitare dhe Bregdetare, sepse konsideron se kjo është me interes të gjithanshëm, për ne dhe për BE-në.

Statusi i realizimit të masave:

- Qeveria më 18 korrik 2017 i miratoi pozicionet negociuese dhe përcaktoi ekipin negociues. Shefi i ekipit është sekretari shtetëror në MPB. Delegacioni është i përbërë nga përfaqësuesit e MPB-së, MPJ-së, SÇE-së dhe DMDHP-së (gjithsej 12 persona). Me këtë ekipi është i autorizuar t'i fillojë negociatat me Komisionin Evropian për Marrëveshjen e Statusit me FRONTEKS-in.
-Më 15.09.2017 në Bruksel, u mbajt takimi i parë i ekipeve negociuese të RM-së dhe KE-së në të cilin në masë të madhe janë harmonizuar qëndrimet ndërmjet të dyja palëve. Më 20.09.2017, KE-ja dorëzoi propozime të reja në lidhje me tekstin e Marrëveshjes, me qëllim të afrimit të qëndrimeve të të dyja palëve. Në rrjedhë është shqyrtimi i propozimeve të fundit të KE-së. Runda e dytë e negociatave është caktuar më 24.11.2017 në Shkup.
- Nga Ministria e Punëve të Brendshme, janë iniciuar mbledhjet teknike me KE-në për harmonizimin e sistemit nacional me kërkesat relevante të BE-së dhe Rregullit të Shengenit.
- MPB-ja / Komisioni Nacional për luftën kundër tregtisë me njerëz dhe migrimin joligjor me ndërmjetësimin e IOM-it më 13 dhe 14.09.2017 organizoi punëtori ku u ftuan përfaqësuesit e njësisë speciale të Serbisë, si dhe përfaqësuesit e Greqisë me qëllim të shqyrtimit të përvojave të tyre dhe praktikave më të mira.
-Duke pasur parasysh se Njësia Nationale për parandalimin e kontrabandimit të emigrantëve dhe tregtisë me njerëz (task force) do të përbëhet prej prokurorëve publikë të Prokurorisë Publike Themelore për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe përfaqësuesve të njësive të ndryshme organizative në MPB, janë mbajtur një numër i madh takimesh pune ndërmjet të dyja institucioneve.
-Në drejtim të realizimit të këtij aktiviteti është detektuar nevoja nga lidhja e Memorandumit për bashkëpunim ndërmjet Prokurorisë Publike dhe MPB-së me të cilin do të parashihen masat për përforcimin e bashkëpunimit në luftën kundër kontrabandimit të emigrantëve dhe tregtisë me njerëz. Në bazë të Memorandumit, prokurori publik do të emërojë udhëheqës dhe zëvendësudhëheqës të njësisë speciale nga radha e prokurorëve publikë të Prokurorisë Publike Themelore për parandalimin e krimit të organizuar, kurse ministri i Punëve të Brendshme do t'i caktojë përfaqësuesit e njësive të ndryshme organizative në MPB të cilët do të marrin pjesë në punën e njësive speciale.
- Sa i përket revidimit të Ligjit për azil dhe mbrojtje të përkohshme në pajtim me rekomandimet e ekspertit të KE-së, nga 10-14.07.2017 u mbajt misioni i ekspertëve TAIEKS për azil i dedikuar për përgatitjen e ligjit të njëjtë. Më 06.09.2017 u përcjell Propozim-ligji dhe dokumentet përcjellëse në KE. Më 06.11.2017 janë marrë komentet e KE-së dhe këto do të merren parasysh.